

# EKOLOGJIA NGA KËNDVËSHTRIMI ISLAM

## Hyrje

Planeti ynë ekziston me miliarda vite dhe ndryshimi klimatik në vetvete nuk është diçka e re. Klima e tokës ka kaluar faza të ndryshme të lagështisë dhe të thatësisë, të të ftohtit dhe të të nxehtit, të shkaktuara nga faktorë të ndryshëm natyrorë. Shumica e këtyre ndryshimeve janë zhvilluar në mënyrë graduale, kështu që format e jetës dhe bashkësitë njerëzore janë përshtatur në përputhje me këto ndryshimet në natyrë. Ka pasur edhe ndryshime klimatike katastrofike, që kanë shkaktuar edhe zhdukje masive, mirëpo me kalimin e kohës jeta është përshtatur me këto ndikime, duke lulëzuar sërish me paraqitjen e ekosistemeve të balancuara, të cilat ne sot dimë t'i çmojmë.

Shpejtësia e ndryshimeve globale klimatike sot dallon për nga madhësia në krahasim me ndryshimet graduale që janë zhvilluar në të kaluarën. Për më tepër, kjo shpejtësi është shkaktuar nga vetë njeriu: ne njerëzit jemi bërë një forcë që e dominon natyrën. Epoka në të cilën jetojmë ne në gjeologji gjithnjë e më shumë njihet me emrin antropocene, pra “epoka e njeriut”. Lloji ynë njerëzor, edhe pse i zgjedhur nga Zoti për të qenë rojtar apo kujdestar (*halif*) i tokës, është bërë shkaktar i një prishjeje, shkatërrimi e shkretimi të saj, saqë ne sot rrezikojmë ta përfundojmë jetën tonë në tokë. Shkalla e shpejtësisë së ndryshimit klimatik është e pandalshme, ndërkaq ekuilibri i hollë i tokës (*mizan*) së shpejti mund edhe të mos jetë më.

Vërejmë se Programi mjedisor i Kombeve të Bashkuara (UNEP, 2005), i mbështetur nga mbi 1300 shkencëtarë nga 95 vende të botës, ka konstatuar se “marrë në përgjithësi, njerëzit kanë shkaktuar ndryshime më të mëdha në ekosistem në gjysmën e fundit të shek. XX sesa në ndonjë kohë tjetër në historinë e njerëzimit... këto ndryshime e kanë rritur mirëqenien njerëzore, mirëpo janë shoqëruar edhe me degradimin gjithnjë në rritje (të mjedisit tonë).”

Ngrohja globale dhe harxhimi i energjive tokësore në emër të zhvillimit ekonomik dhe të avancimit të njerëzimit po bëhet gjithnjë e më tepër alarmues, sidomos kur të kihet parasysh ndikimi i kombinuar i rritjes së vazhdueshme të numrit të popullatës së përgjithshme botërore dhe të rritjes alarmante të harxhimeve për kokë banori. Me veprimet e këtilla ne e përshpejtojmë shkatërrimin tonë personal në planetin tokë.<sup>1</sup>

Duke u nisur nga këto të dhëna rrëqethëse që i ofrojnë shkencëtarët dhe organizatat e ndryshme botërore që e kanë dert dhe shqetësim të tyre ruajtjen e ambientit dhe të planetit tokë, parashtrohet pyetja se çfarë do t'u themi gjeneratave pas nesh për ne, që po u lëmë tra-

---

<sup>1</sup> *Islamic Declaration on Global Climate Change*, Stamboll 2015. [www.ifees.org.uk/declaration](http://www.ifees.org.uk/declaration).

shëgimi një planet të varfëruar e të shkretuar? Si do ta takojmë Zotin, Krijuesin tonë, i Cili këtë planet na ka lënë amanet?

Të shqetësuar jashtë mase për këto ndryshime përmasash të pandalshme, sot thuajse në gjithë botën, njerëz të merakosur e sidomos brezat e rinj, demonstrojnë përpara parlamenteve dhe zyrave me rëndësi shtetërore, për ta zgjuar ndërgjegjësimin dhe ndjenjën e përgjegjësisë së secilit, por në radhë të parë të instancave qeverisëse, ndaj kësaj katrahure që po na shkel heshtazi të gjithë ne.

Mbase dikush mund të thotë se çfarë roli mund të luajmë ne shqiptarët disa milionësh në këto çështje të mëdha planetare? Sa mund të ndikojmë ne për ta përmirësuar këtë gjendje? Tekfundit sa mund ta kemi dëmtuar ne një grusht njerëz në tokë këtë baraspeshë përmasash botërore? Madje mund ta quajmë edhe të kotë, madje edhe punë luksi, trajtimin e kësaj teme, duke qenë se kemi probleme më të mëdha dhe më jetësore sesa kujdesi për ambientin. Mirëpo, duke u nisur nga fakti se secili prej nesh jemi banorë të këtij planeti dhe se sa kemi hise në të mirat e tij po aq e kemi edhe përgjegjësinë për gjërat që nuk shkojnë, ne na vë përpara një përgjegjësie të padiskutueshme qoftë në nivel lokal qoftë edhe më gjerë. Mungesa e vetëdijes dhe e përgjegjësisë për ruajtjen e ambientit në nivel lokal është shenjë se ne edhe në nivele të tjera më të gjera ose më të larta do të kemi po të njëjtën mungesë vetëdijeje dhe përgjegjësie. Ne, nuk e mohojmë faktin se përgjegjësia më e madhe sot dhe çdo herë u takon atyre që e dëmtojnë dhe e ndotin më së shumti planetin tonë në nivel global, mirëpo asnjë individ nuk i ik dot përgjegjësisë personale. Edhe sikur të mos ishte ngrohja globale dhe problemet e tjera ekologjike që sot janë bërë brengë serioze, njeriu nuk i ik dot përgjegjësisë për ruajtjen dhe kujdesin ndaj ambientit. Pra, në plan të parë vjen ruajtja e rendit, e sistemit dhe e ambientit si detyrë parësore e secilit individ, e tek pastaj, domosdo dhe rrjedhimisht, edhe përmirësimi i asaj që mund të jetë dëmtuar, prishur e çrregulluar. Kur është në pyetje përgjegjësia, pothuajse të gjithë ne zakonisht priremi që atë ta kërkojmë te tjetri, duke harruar se edhe ne për të tjerët jemi "tjetri". Andaj, nga secili prej nesh pritet ta bëjmë më të mirën që mundemi.

Në këtë artikull ne do të mundohemi të japim mendimin islam karshi këtyre temave, duke nisur me burimin e parë të Islamit, pra me Kur'anin Fisnik, duke vazhduar me traditën shembullore të Muhammedit a.s. si dhe duke e përmbyllur me disa refleksione të përgjithshme për në të ardhmen.

## **Përkufizimi i disa termave**

Ambient quajmë tërësinë e kushteve natyrore, shoqërore dhe kulturore në të cilat jeton, vepëron dhe zhvillohet njeriu. Këtu bën pjesë banesa a shtëpia e tij, kopshti dhe oborri i tij, mjeti i udhëtimit, rruga, natyra përreth, ajri, uji, vendbanimi etj.<sup>2</sup>

Ndotja e ambientit është futja e ndotësve në mjedis, që shkakton dëmtim dhe çrregullim të sistemeve dhe ekosistemeve të mjedisit. Ndotja mund të jetë natyrale, si në rastin e vullkaneve, ose mund të shkaktohet nga aktivitetet njerëzore. Format kryesore të ndotjes të shkaktuar nga njeriu janë: ndotja e ajrit, ndotja e ujit, ndotja e tokës, ndotja nga zhurmat dhe ndotja radioaktive.<sup>3</sup>

---

<sup>2</sup> Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Fjalor i Shqipes së Sotme*, Botimet Toena, Tiranë 2002, f. 796-797; Doğan, Mehmet, *Büyük Türkçe Sözlük*, Vadi Yayınları, Ankara 2001, f. 304.

<sup>3</sup> Instituti i Politikave Mjedisore: [www.iep-al.org/?page\\_id=58&lang=sq](http://www.iep-al.org/?page_id=58&lang=sq) (shikuar më 06.10.2019)

Ekologjia (greq. *oikos* – shtëpi dhe *logos* – fjalë, shkencë) është degë e biologjisë, e cila studion marrëdhëniet e ndërsjella të qenieve të gjalla të botës bimore e shtazore me mjedisin ku jetojnë.<sup>4</sup>

Ekologjizmi apo ambientalizmi nënkupton angazhimin e individëve apo të komuniteteve të tëra në formë të lëvizjes për ngritjen e vetëdijes në ruajtjen e ambientit në mbarë planetin tokë.

## Ambienti në prizmin e Kur'anit

Çështjes së ambientit Kur'ani i qaset nga një perspektivë shumë më e gjerë. Ai shihet si pjesë e pandashme e gjithë kozmosit që ka krijuar Zoti, All-llahu Fuqiptotë. Madje, Kur'ani shkon edhe përtej kësaj të dukshmes, e kap edhe përtej-fiziken, metafiziken.

Sipas Islamit, natyra është krijesë dhe dhuratë e Zotit. Si krijesë, ajo është teleologjike, e përkryer dhe e rregullueshme; kurse si dhuratë ajo është një e mirë e padjallëzuar, e lënë në dorë të njeriut. Qëllimi i saj është t'ia mundësojë njeriut realizimin e së mirës dhe arritjen e lumturisë. Ky gjykim i trefishtë: i rregullsisë, i qëllimshmërisë dhe i mirësisë e karakterizojnë dhe e përmbledhin pikëpamjen e Islamit ndaj natyrës.<sup>5</sup>

Sipas mësimëve kur'anore, pronari i vetëm i krejt ambientit ku jetojmë ne, si pjesë e makrokozmosit, është All-llahu, Krijuesi i universit. *“Atij i takon çka në qiej e në tokë...”*, është një shprehje që shumë herë përmendet në Kur'an, p.sh. 2:116, 2:255 etj. Të gjitha krijesat, me ose pa shpirt, janë krijuar nga All-llahu xh.sh. për një **qëllim të caktuar**: *“Ne nuk kemi krijuar qiellin dhe Tokën, e ç'gjendet në mes tyre, për t'u argëtuar (pa ndonjë qëllim)”* (el-Enbija', 21:16), me **masë të caktuar**: *“Ne çdo send kemi krijuar me masë të caktuar”* (el-Kamer, 54:49), sipas një **rendi a sistemi të caktuar**: *“Dhe mos bëni çrregullime në tokë, pasi në të është vënë rregulli, rendi..!”* (el-A'raf, 7:56, 85), **në një baraspeshë kozmike**: *“Mëshirëploti. Ia ka mësuar (njeriut) Kur'anin. E ka krijuar njeriun. Ia ka mësuar të shprehurit. Dielli dhe Hëna lëvizin sipas llogaritjes së caktuar. Bimët dhe drunjtë i përkulen Atij. Ai e ngriti qiellin dhe e vendosi peshoren (baraspeshën)\*. Që të mos e prishni baraspeshën. Prandaj, ruajeni peshoren (baraspeshën) me drejtësi e mos e dëmtoni atë!”* (er-Rahman, 55:1-9) dhe **në formën më të përkryer**: *“Ai, i Cili ka krijuar shtatë qiej njërin mbi tjetrin, - ti nuk vëren në krijesat e Mëshiruesit kurrfarë disharmonie, dhe shiko edhe një herë a mos po sheh ndonjë plasaritje?!”* (el-Mulk, 67:3).

Krijimi i ekzistencave në gjithësi nga ana e Zotit në formën më të mirë dhe brenda një rendi, sistemi e baraspeshe, quhet “baraspeshë ekologjike”.<sup>6</sup> Si një pjesë e këtij sistemi dhe baraspe-

<sup>4</sup> Grup autorësh, *Fjalor i Fjalëve të Huaja*, Rilindja, Prishtinë 1988, f. 158.

<sup>5</sup> El-Faruki, Ismail Raxhi, *Tevhidi – Implikimet e tij për mendimin dhe jetën*, Logos-A, Shkup 2006, f. 107.

\* Fjala *mizan* që përmendet në ajetet 7, 8 dhe 9 të kësaj sureje zakonisht është kuptuar dhe përkthyer si peshore, drejtësi, matje me drejtësi etj. Vetëm tani kohëve të fundit, duke u nisur nga konteksti i ajeteve paraprake dhe atyre që vijnë pas tyre, dhe duke u nisur nga zhvillimet shkencore, jepet të kuptohet se këtu nuk është fjala për mjetin matës dhe ruajtjen nga matja shtrembër dhe me hile, porse këtu është fjala për baraspeshën, për ekuilibrin, për balancën dhe për ruajtjen e kësaj baraspeshe në gjithësi, në univers, natyrisht edhe në mjedisin e tij ku ai jeton njeriu. Shprehja “baraspeshë ekologjike” besoj se është pikërisht ajo që nënkuptohet në këto ajete. Prandaj edhe preferoj që fjalën *mizan*, në këto ajete, ta përkthej me “baraspeshë”, “balancë”.

<sup>6</sup> Özdemir, İbrahim, *Çevre ve Din*, Çevre Bakanlığı Yayınları, Ankara 1997, f. 123.

she njeriu është krijesa më e ndershme e Zotit<sup>7</sup> dhe një *halif* (mëkëmbës) i cili kujdeset që në tokë të realizohet vullneti i Krijuesit. Në Kur'an thuhet: *"Unë do të caktoj në tokë një mëkëmbës (përfaqësues, halif)..."* (el-Bekara, 2:30) si dhe *"Ai (All-llahu) ju ka bërë ju mëkëmbës në Tokë..."* (Fatir, 35:39). Ndërsa Muhammedi a.s. në këtë drejtim ka thënë: *"Vërtet kjo botë është e ëmbël dhe e gjelbër (joshëse), ndërkaq All-llahu ju ka caktuar juve halifë (mëkëmbës) të Tij në të..."*<sup>8</sup>

Nëse arrimë ta kapim tërësinë e asaj që ka për qëllim Kur'ani fisnik për temën që po e trajtojmë, do të shikojmë se Kur'ani përmban shenja dhe mesazhe që "baraspeshën" e trajtojnë nga këndvështrime të ndryshme. Meqë problemet ekologjike janë rrjedhojë e prishjes së baraspeshës që ekziston në natyrë, atëherë nuk do të arrimë ta eksplorojmë saktë këndvështrimin kur'anor në lidhje me mjedisin pa folur për baraspeshën dhe harmoninë e gjithmbarëshme që sundon në univers. Një infrastrukturë teorike për këtë mund të nxirret nga ajetet kur'anore që flasin për këtë ekuilibër dhe harmoni kozmike. Nëse i lexojmë nga këndvështrimi ekologjik ajetet 7 dhe 8 të sures së 55-të, pra të sures er-Rahman, të cilën lirisht mund ta quajmë "sure të ambientit" ose "sure ekologjike", ato do të na japin një mesazh të fuqishëm dhe të mjaftueshëm për temën që po e trajtojmë. Këto ajete, jo vetëm që e theksojnë harmoninë dhe ekuilibrin kozmik, ndaj edhe ekologjik, të krijuar nga Zoti, por ato përmbajnë edhe mesazhin se njeriu duhet ta eksplorojë këtë univers dhe këtë natyrë, se gjatë këtij eksplorimi ai do të ketë mundësinë edhe të ndërhyjë në të, mirëpo gjithsesi, si amanet-marrës që është, ai e ka për obligim edhe ruajtjen e kësaj baraspeshe, ekuilibri ekologjik.<sup>9</sup>

Duke u mbështetur në këtë pozitë që Kur'ani ia njuh njeriut në kozmos, ai ripohon se gjithçka që është në qiej, në tokë dhe midis tyre është krijuar për të qenë në shërbim të njeriut. Në Kur'an thuhet: *"Perëndia është Ai që ka krijuar qiejt dhe Tokën; Ai zbret ujën nga qielli e me të jep frutat për t'u ushqyer ju; dhe ju jep juve (mundësinë) që të shfrytëzoni anijet për të lundruar me to nëpër dete, me autorizimin e Tij, dhe ju jep që të shfrytëzoni lumenjtë; dhe ju jep që të shfrytëzoni Diellin dhe Hënën, që lëvizin vazhdimisht, dhe ju jep që të shfrytëzoni natën dhe ditën; dhe ju jep nga të gjitha ato që keni kërkuar nga Ai (sipas nevojave tuaja), e nëse doni t'i numëroni dhuntitë e Perëndisë, atëherë nuk do të mund t'i numëroni. – Njeriu, me të vërtetë, është zullumqar dhe mosmirënjohës."* (Ibrahim, 14:32-34); *"A nuk shihni, se si Perëndia u ka mundësuar – t'i shfrytëzoni të gjitha ato që gjenden në qiej dhe në Tokë dhe ju ka plotësuar dhuntitë e Tij – të jashtme dhe të brendshme?..."* (Lukman, 31:20); *"Perëndia është Ai që ju ka nënshtruar juve detin, që, nëpër të me urdhrin e Tij, të lundrojnë anijet, për t'i kërkuar dhuntitë e Tij dhe për të qenë ju mirënjohës. Dhe ju ka nënshtruar juve çka gjendet në qiej dhe në Tokë, të gjitha janë prej Tij. Me të vërtetë, në këto ka këshilla për popullin që mendon."* (el-Xhathijeh, 45:12-13).

Kjo, në asnjë mënyrë nuk nënkupton keqpërdorimin, eksplotimin dhe shkatërrimin apo shkretimin e asaj që njeriut i është dhënë në shfrytëzim për t'u shërbyer në jetën e tij të përditshme. Pikërisht nga arsyeja se ambienti, me krejt çfarë ai përmban, i është dhënë njeriut si amanet, në besë, për t'u kujdesur për të në mënyrën më të mirë të mundshme. Në këtë kontekst, All-llahu xh.sh. thotë se njeriu nuk është krijuar dosido dhe pa ndonjë përgjegjësi në këtë gjithësi: *"Vallë, a mendon njeriu se do të mbetet pa obligime (pa përgjegjësi)?"* (el-Kijameh,

<sup>7</sup> *"Ne me të vërtetë i kemi nderuar bijtë e Ademit (njerëzit), i kemi shëtitur nëpër tokë e nëpër det dhe i kemi furnizuar me ushqime të mira e me shije, dhe u kemi dhënë përparësi të mëdha ndaj shumicës që i kemi krijuar."* (el-Isra', 17:70)

<sup>8</sup> Muslimi, Rikak, 1.

<sup>9</sup> Grup autorësh, *İlmihal – İslam ve Toplum*, İSAM, vëll. II, Ankara 2001, f. 461-462.

75:36). Amaneti nuk është pronë e njeriut, prandaj edhe ai mund të përdoret nga ana e njeriut vetëm sipas vullnetit dhe kushteve të pronarit, me këtë rast të Zotit.

Sipas Kur'anit, njeriu nuk mund të sillet me ambientin e tij në mënyrë të papërgjegjshme dhe egoiste. Sepse ai për të gjitha sjelljet dhe veprimet e tij do të merret në pyetje në botën tjetër, ku bën pjesë edhe sjellja e tij ndaj mjedisit ku ka jetuar: *"Pastaj në atë ditë do të pyeteni gjithsesi për të mirat (e dynjasë)."* (et-Tekathur, 102:8) Duke qenë se Zoti njeriun e ka krijuar në formë të plotë e të drejtë: *"I Cili të krijoi, të përsosi dhe të drejtoi."* (el-Infitar, 82:7), Ai kërkon nga njeriu që të sillet në mënyrë të matur dhe korrekte ndaj ambientit: *"O populli im, (tha Shuajbi a.s.), veproni drejtë gjatë matjes dhe peshimit, e mos dëmtoni njerëzit në asgjë dhe mos shkaktoni rrëmujë në tokë!"* (Hud, 11:85); *"E mos shkoni pas atyre që janë të pa frenuar (që e teprojnë me vepra të këqija). Të cilët në tokë bëjnë shkatërrime e nuk bëjnë mirë."* (esh-Shu'ara', 26:151-152).

Të jesh njeri, pra, nënkupton të jesh i vetëdijshëm për përgjegjësinë që lind nga pozita e të qenit mëkëmbës i Zotit në tokë.

Thamë që përsikaj dimensionit fizik, Kur'ani ambientit i qaset edhe nga ai metafizik. Mund të thuhet që të gjitha qeniet e gjalla dhe jo të gjalla kanë një sistem, një mekanizëm, një mision, një gjuhë dhe pothuajse një shpirt. Kur'ani thekson se të gjitha krijesat e Zotit në natyrë e madhërojnë Zotin vazhdimisht: *"Lartmadhëri të merituar i shprehin Atij shtatë qiejt e toka dhe çka ka në to, e nuk ka asnjë send që nuk e madhëron (nuk i bënë tesbih), duke i shprehur falënderim Atij, por ju nuk e kuptoni atë madhërim të tyre (pse nuk është në gjuhën tuaj). Ai është i butë dhe fal shumë."* (e-Isra', 17:44); *A nuk e di për All-llahun se Atij i lutet kush është në qiej e në tokë, madje edhe shpezët krahëhapur. Të gjithë e dinë dhe janë të udhëzuara në lutje ndaj Tij dhe për madhërimin e Tij. All-llahu e di ç'punojnë ata."* (en-Nur, 24:41).

Kur'ani po ashtu thekson se edhe kafshët janë *ummet* apo "bashkësi", si njerëzit: *"Nuk ka asnjë gjallesë në tokë dhe as shpendë që fluturojnë me dy krahë e që nuk janë bashkësi (umem), sikurse edhe ju..."* (el-En'am, 6:38). Përcjell Ebu Hurejra r.a. se Muhammedi a.s. ka thënë: "Një prej pejgamberëve të mëparshëm e kafshoi një milingonë dhe ai urdhëroi që të digjej gjithë kolonia e milingonave që ishin aty. Atëherë Zoti i tha atij: *'Për një milingonë që të kafshoi e shkatërrove një popull të tërë (milingonash), të cilët më madhëronin Mua?!'*"<sup>10</sup>

Nga ky aspekt, të gjitha elementet që janë në ambientin tonë, janë të vlefshme dhe pikërisht për këtë edhe meritojnë respektin tonë.

Kur Zoti ia përcjell njeriut mesazhin e Tij në Kur'an, kur Ai komunikon me njeriun, Ai shpesh përdor edhe shembuj të bimëve, të luleve, të pemëve, të kodrave, të fushave apo luginave, të kafshëve, të qiellit e të yjeve që e përbëjnë ambientin e tij të afërt dhe të largët natyror. Kjo domosdo te njeriu krijon një ndjeshmëri ndaj mjedisit të vet, parashikon përshkrimin e një vlere materiale dhe shpirtërore ndaj tyre nga ana e njeriut si dhe zgjon ndjenjën e afërsisë ndaj tyre. Me këtë tentohet të gjenerojë një dashuri te njeriu ndaj ambientit të tij si dhe të formohet një mendësi e ngulitur thellë tek ai për ruajtjen e atij ambienti. Njerëzit që nuk e humbasin lidhjen e tyre me Kur'anin, nuk e kanë vështirë të krijojnë dhe të përfitojnë një mendësi të këtyllë.<sup>11</sup>

<sup>10</sup> Ibni Maxhe, Selam, 39.

<sup>11</sup> Sancaklı, Saffet, Hz. Pezgamber'in Çevrecilik Anlayışı, *İslami Araştırmalar Dergisi*, cilt 14, sayı 3-4, Ankara 2001, f. 409.

Nga ky aspekt në Kur'an kafshët (fauna) dhe bimët (flora) zënë një vend të rëndësishëm. Kështu disa sure apo kapituj të Kur'anit bartin emra kafshësh, si el-Bekare (lopa), en-Neml (milingonat), el-Fil (elefanti), en-Nahl (bleta), el-Ankebut (merimanga). Përndryshe në Kur'an janë përmendur diku 35 lloje të kafshëve, shumica e të cilave janë gjitarë: lopa (2:67), viçi (11:69), gjarpri (7:107), pitoni (7:107) deveja (88:17, kali (16:8), gomari (62:5), mushka (16:8), dhia (7:143), dhentë (7:143, 38:23), derri (2:173), majmuni (7:166), qeni (18:18), luani (74:51), elefanti (105:1), ujku (12:10), zebra (74:50), thëllëza (2:57), ebabili, lloj dallëndysheje (105:3), mushkonja (2:26), karkaleci (7:133), rriqra (7:133), bretkosa (7:133), miza (22:73), bleta (16:68), merimanga (29:41), milingona (27:18), flutura (101:4), balena (37:132), pupëza (27:20), sorra (5:31) etj.<sup>12</sup> Në Kur'an po ashtu janë përmendur edhe pemët, perimet dhe bimët në vijim: qepa (2:61), thjerrëza (2:61), fiku (95:1), sinapi (21:47, 31:16), shega (6:99, 6:141, 55:68), borziloku (55:12), kastravec, trangulli (2:61), palma, hurma (13:4, 16:11, 16:67, 80:29), hudhra (2:61), kungulli (37:146), rrushi, hardhia (13:4, 16:11, 16:67, 80:28), ulliri (6:99, 16:11, 6:141, 23:19, 24:35, 80:29, 95:1), bananet (56:29), kamfuri (76:5), lotusi, zambaku i ujit (56:28), tamariska, bruka (34:16), zenxhefili (75:17) etj.<sup>13</sup> I gjithë ky biodiversitet meriton respekt nga ana e njeriut, pasi ai është po ashtu produkt dhe krijimtari e të Madhit Zot, të cilën Ai na ka lënë amanet dhe në besë.

Kur'ani, i cili ka ardhur për ta pastruar, ndriçuar dhe qetësuar botën e brendshme, mendjen, zemrën dhe shpirtin e njeriut, këtë ai e lidh drejtpërdrejtë edhe me pastrimin e botës së jashtme fizike të njeriut. Ai kërkon nga besimtari musliman që të pastrohet kur ta marrë Kur'anin në dorë<sup>14</sup>, të pastrohet me ujë (abdest) para se të lutet (në namaz), ndërkaq në rast të mungesës së ujit, atëherë me pastrim simbolik me dhé të pastër (tejemmum)<sup>15</sup> dhe e ka shpallur tokën fetarisht të pastër për t'u pastruar me të dhe për të falur namaz në të. Muhammedi a.s. ka thënë: *"Më janë dhënë pesë sende që nuk i janë dhënë ndonjë pejgamberi para meje... më është bërë toka e pastër dhe faltore..."*<sup>16</sup> Krahas krejt këtyre kushteve, Kur'ani kërkon edhe pastërtinë e teshave<sup>17</sup>, si kusht bazë për kryerjen e ritualeve fetare. Këtu vërejmë se këto ajete e hadithe (fjalë të Muhammedit a.s.) që flasin për pastërtinë shpirtërore dhe trupore të njeriut, mund të themi se në instancë të fundit në psikologjinë e njeriut krijojnë një perceptim të gjithanshëm të "pastërtisë". Koncepti i pastërtisë në Islam, sipas kësaj, përfshinë pastërtinë e shpirtit nga veset dhe mendimet e këqija, pastërtinë e trupit, të teshave por edhe të mjedisit. Këto nuk mund të mendohen të ndara nga njëra-tjetra. Pastrimi me ujë ose edhe me dhé të pastër, në formë simbolike, krijon një lidhshmëri të drejtpërdrejtë të njeriut me ambientin ku jeton dhe e zgjon vetëdijen për ruajtjen e pastërtisë së tij. Kjo nënkupton detyrën e mos-

<sup>12</sup> Karić, Enes, Ekološke Poruke Kur'ana – Uvodna razmatranja, *Novi Muallim*, nr. 35, 29, shtator 2008, f. 68; Bahjat, Ahmad, *Kisas el-hajevan fi'l-Kur'an*, Dar al-Shuruk, bot. 4, Kajro 2000: Versioni në anglisht i këtij libri, *Animals in the Glorious Qur'an – Relating Their Own Stories*, gjendet në [www.archiv.org](http://www.archiv.org).

<sup>13</sup> Darakhsha, Kauser & Ashwini, Kumar Dixit, Plants in the Holy Quran: A Look, *World Journal of Pharmacy and Pharmaceutical Sciences*, vëll. 4, nr. 8, Bilaspur 2015, f. 715-738.

<sup>14</sup> "Atë (Kur'anin) nuk e prek kush përveç të pastruarit." (el-Vaki'ah, 56:79)

<sup>15</sup> "O besimtarë! Kur doni të bëni namaz lajeni fytyrën dhe duart tuaja deri në bërryla dhe fshijeni kokën me dorë të lagët; lani edhe këmbët deri në nyje. E, nëse jeni xhunub, pastrohuni! Por, në qoftë se jeni të sëmure (që mund t'u dëmtojë uji), ose gjendeni në udhëtim, ose ndonjëri nga ju vjen pas kryerjes së nevojës natyrore, ose nëse keni pasur marrëdhënie (seksuale) me bashkëshortet tuja dhe nuk gjeni ujë (për abdest apo gusël), atëherë gjeni (bëni tejemmum) në dhé të pastër dhe fshijeni fytyrat tuaja dhe duart me të. Perëndia nuk dëshiron t'ju krijojë ndonjë vështirësi juve, por dëshiron t'ju pastrojë dhe t'i plotësojë dhuntitë e Tij ndaj jush, që të jeni falënderues." (el-Maideh, 5:6)

<sup>16</sup> Buhariu, Tejemmum, 1; Muslimi, Mesaxhid, 5.

<sup>17</sup> "Dhe petkat tua pastroji!" (el-Muddeththir, 74:4)

ndotjes së ambientit. Islami në radhë të parë kërkon ruajtjen dhe mosndotjen e ambientit, e jo korrigjimin, ndreqjen dhe rregullimin apo rikthimin në gjendjen fillestare. E dyta është më e vështirë dhe më e kushtueshme.

Përshkrimet e Xhennetit\*, nuk e kanë vetëm dimensionin e botës tjetër, ku do të jetojnë përgjithmonë të lumtur ata që në këtë botë kanë jetuar sipas vullnetit të Zotit, por ato përmbajnë edhe mesazhe të fuqishme për mjedisin tonë sot në këtë botë. Emërtimi i parajsës me emrin “xhenet”, që d.m.th. “kopsht”, për arabët e shkretëtirës e të vendeve të thata ka një kuptim shumë të madh e të thellë. Mirëpo, me shkretimin e tokës, me shkatërrimin e pyjeve dhe me betonimin e fushave tona, përshkrimet e xhenetit në Kur’an po fitojnë një kuptim dhe domethënie të veçantë.<sup>18</sup>

Duke qenë se është kështu, Zoti kërkon nga njeriu që ai ta ruajë rendin, sistemin dhe baraspeshën ekologjike: “*Prandaj, ruajeni peshoren (baraspeshën) me drejtësi e mos e dëmtoni atë!*” (er-Rahman, 55:9); “*Dhe mos bëni çrregullime në tokë, pasi në të është vënë rregulli, rendi..!*” (el-A’raf, 7:56, 85); “*...Mos teproni, pse Ai (All-llahu) nuk i do ata që e teprojnë (shkapërderdhin).*” (el-A’raf, 7:31); “*Ata që shpenzojnë tepër (mastrafxhinjtë) janë vëllezër (në veprim) të djajve, e djalli është përbuzës i madh i Zotit të Tij.*” (el-Isra’, 17:27).

Koncepti kur’anor për ndotjen e ambientit, përveç fjalës *sherr* që edhe në gjuhën shqipe tani më është rrënjësor mirë, është edhe fjala *fesad*, që nënkupton “prishje, shpërbërje, shkatërrim, kalbje, dëm, zarar, përçarje, grindje, degjenerim, përdhosje, zvetënim, çoroditje, prapësi, poshtërsi” etj.<sup>19</sup> Disa komentues të Kur’anit si Kurtubiu, Begaviu, Zemahsheri etj. fjalën *fesad* e komentojnë me mosrënie të shiut, me pakësim të bimëve dhe të bereqetit, me një fjalë si prishje të baraspeshës natyrore të ambientit.<sup>20</sup> Sipas botëkuptimit kur’anor, në qoftë se njeriu nuk e mposht dot dëshirën e tij për të dominuar mbi natyrën dhe me këtë rast e prish bukurinë, rendin dhe sistemin e ambientit, të parët që do të preken nga ky dëm janë vetë njerëzit bashkë me ata që ndodhen në këtë “anije”. Kur’ani shprehet kështu: “*Për shkak të vepërave (të këqija) të njerëzve, është shfaqur në tokë e në det fesadi (belaja, skamja, katastrofa, humbja e bereqetit etj.), e për ta përjetuar ata një pjesë të kësaj të keqeje që e bënë, ashtu që ndoshta tërhiqen (nga të këqijat).*” (er-Rum, 30:41)

*Fesadi* nënkupton prishjen e një rendi, pengimin e funksionimit normal të tij dhe dëmtimin duke e zhdukur të dobishmen brenda tij. *Fesadi* është një çrregullim që është rezultat i një qëllimi të keq, të vetëdijshëm, për të shkaktuar dëm. Lidhur me këtë Kur’ani fisnik thotë: “*Ka ndonjë nga njerëzit që fjala e tij të mahnit, por vetëm në këtë botë (pse në botën tjetër gjykon Ai që i di të fshehtat), dhe për atë që ka në zemrën e tij, e paraqet All-llahun dëshmues, e në realitet ai është kundërshtari më i rreptë. E posa të kthehet, ai në tokë ngarend të bëjë shkatërrim në të, të asgjësojë të korrat (mbjelljet) dhe gjallesat. E All-llahu nuk e do çrregullimin (fesadin).*” (el-Bekara, 2:204-205). Në këtë ajet flitet për një mendësi, mentalitet të dëmshëm që manifestohet madje edhe si formë kulture, jo vetëm si një reagim i atypëratyshëm personal i një njeriu të çorientuar, në shkatërrimin dhe shkretimin e natyrës në përgjithësi dhe të ambientit në veçanti. Në qoftë se e kemi parasysh fatkeqësinë me të cilën ballafaqohet sot njerëzimi në fushën e shëndetit dhe të të ushqyerit, besoj se vërejtjen që e shpreh ky ajet kur’anor mund

\* Më gjerësisht për përshkrimet e Xhennetit shiko el-Xheuzi, Ibën Kajjim, *Përshkrimi i Xhennetit*, Shkup 2005.

<sup>18</sup> Von Denfer, Ahmad, *Islam und Umwelt*, Islamisches Zentrum München, 1999, f. 10-11.

<sup>19</sup> Memishi, Isa, *Fjalor arabisht – shqip*, Logos A, Shkup 2014, vëll. II, zëri “f-s-d”, f. 301.

<sup>20</sup> Akyüz, Hüseyin, “Çevre dostu bir Peygamber: Hz. Muhammed”, *Journal of Turkish Studies*, vëll. 9/2, dimër 2014 Ankara, f. 111.

të kuptohet më lehtë dhe më qartë. Në një kohë kur thuajse gjithçka po bëhet artificiale dhe po del nga natyra dhe natyrshmëria e vet përmes ndryshimit apo ndërhyrjes njerëzore në hormonet e tyre, njeriu dhe mbarë njerëzimi po e shikon i zhgënjyer dhe i pafuqishëm tatë-pjetën e tij drejt një humnere të përbashkët.<sup>21</sup>

Në krye të ndotjes së ambientit dhe të prishjes së ekuilibrit ekologjik sot shihet prirja e pandalshme për rritje, zmadhim dhe shtim ekonomik si dhe prirja për shkapërderdhje dhe për harxhim të tepruar e të kotë, shpeshherë të pakuptimtë. Aty qëndron egoizmi i stërtheksuar individual dhe kolektiv. Njerëzit sot sikur po garojnë me njëri-tjetrin në harxhime të kota dhe këtë e shohin edhe si virtyt apo si shenjë të ngritjes dhe prosperitetit. Ndërkaq, njerëzimi sa është duke e paguar tani për tani çmimin e rëndë të kësaj plëngprishjeje, aq më shumë do ta paguajë edhe në të ardhmen. Porosia kur'anore *"hani dhe pini, por mos e teproni, se All-llahu nuk i do tepruesit!"* (el-A'raf, 7:31), ofron jo vetëm një parim ekonomik, por para së gjithash etik, që përfshinë të gjitha fushat e veprimit njerëzor, në rastin tonë konkret në ruajtjen e mesatares, të ekuilibrit e të baraspeshës ekologjike. Ruajtja e mesatares dhe kujdesi për të në Islam fiton karakterin e një filozofie jete. Porosia tjetër kur'anore e përforcon akoma më shumë këtë që thamë: *"Dhe jepi çdo të afërmi të drejtën që i takon, edhe të varfrit, edhe atij në vend të huaj, po mos shpenzo tepër e pa rrugë. Ata që shpenzojnë tepër (mastrafxhinjtë) janë vëllezër (në veprim) të djajve, e djalli është përbuzës i madh i Zotit të Tij."* (el-Isra', 17:26-27). Këto dy ajete, kujdesin për tjetrin e ngrenë në detyrë parësore fetare dhe këtu nuk bën pjesë vetëm kujdesi për barkun e tyre por edhe për mushkëritë e tyre, për sytë e tyre, për veshët e tyre, me një fjalë për jetën e tyre. Shpenzimi i tepërt, vend e pavend, ndikon drejtpërsëdrejti në realizimin e detyrës së kujdesit ndaj tjetrit. Teprimi në të mirat materiale, shihet si ves jo etik, si punë djallëzore. Kjo mund të çojë në një stad ku njeriu nis ta harrojë pozitën e vet reale në këtë univers, nis ta shikojë veten të pavdekshëm, të amshueshëm, sepse në bazë të të mirave materiale që ka dhe të cilat ai i konsideron si të pashtershme, i japin atij mundësinë që edhe jetën e tij ta shikojë të pashtershme. Tipin e njeriut të këtillë Kur'ani e përshkruan kështu: *"Mjerë për atë që ka tubuar pasuri dhe që e ruan atë të (për ardhmërinë e ëndërruar), dhe që mendon se ajo pasuri, do ta bëjë atë të pavdekshëm"* (el-Humezeh, 104:2-3) Në momente shtrëngimi, ky nuk do të ngurojë të mos e shkelë tjetrin, vetëm e vetëm të arrijë te "pavdekshmëria" e tij. Ndërkaq besimtarin e mirëfilltë, Kur'ani e përshkruan si njeri të qetë e të matur: *"E robërit e Zotit janë ata që ecin nëpër tokë të qetë... edhe ata që kur shpenzojnë, nuk e teprrojnë e as nuk janë dorështrënguar, po mbajnë mesataren e janë të matur."* (el-Furkan, 25:63, 67).

Përshkrimet që Kur'ani i bën Ditës së Fundit, pra Kijametit, na japin mesazhe të fuqishme për ndotjen e ambientit dhe për humbjen e baraspeshës ekologjike sot, si p.sh. *"Kur dielli të humbasë shkëlqimin, kur yjet të rrëzohen (errësohen), kur malet të lëvizin, kur devetë mbarsë të mbeten pa kujdes, kur shtazët e egra të tubohen, kur detet të vlojnë..."* (et-Tekvir, 81:1-6); *"Kur të çahet qielli, kur të shkapërderdhen yjet, kur detet të përzihen, kur të trazohen varret, atëbotë secili njeri e din se çka punuar dhe çka ka lënë prapa!..."* (el-Infitar, 82:1-5). Dëmet marramendëse që i shkaktojnë ambientit shpërthimi i centraleve bërthamore, si ai në Çernobil në vitin 1986, armët biologjike dhe kimike, madje vetëm provat e funksionimit të këtyre armëve në dete e oqeanë, qysh sot ta përkujtojnë skenën e tmerrshme të Kijametit të Madh.<sup>22</sup>

<sup>21</sup> Güven, Mustafa, "Kur'ân-ı Kerim'de Çevre Bilincine Dair Bazı Ahlâkî Esaslar", revista *Birey ve Toplum*, vëll. 4, nr. 2, Stamboll 2014, f. 156-157.

<sup>22</sup> Güven, Mustafa, po aty, f. 147.



Ndotja e mjedisit është pasojë e pashmangshme e veprimeve të njeriut që e ka humbur kuptimin e ekzistimit të tij. Ajetet e mësipërme kur'anore na bëjnë me dije se ndotja dhe harxhimi material i ambientit në fakt është pasojë e një ndotjeje shpirtërore që lind nga largimi prej vlerave universale etike. Në mos qentë pasojë e saj, së paku ka një lidhshmëri të fuqishme midis të dyjave, pra ndotjes fizike të ambientit dhe ndotjes shpirtërore të njeriut. Vetëdija më e fuqishme e kontrollit në ruajtjen e bukurive natyrore dhe të të gjitha qenieve në natyrë është vetë ndërgjegjja e njeriut. Ai duhet të arrijë të kuptojë plotësisht dhe me vetëdije të thellë se ndotja e ambientit është mëkat te Zoti, është kundërvajtje nga aspekti juridik, dhe është turp si dhe ngrënie e hakut të të gjithë njerëzimit. Ajo që do ta kontrollojë shoqërinë, respektivisht individin, është sistemi i vlerave të mbështetura në Qenien tejfizike. Natyrisht që është e pamjaftueshme që këtë temë ta lidhim vetëm për vetëdijen, ndërgjegjen dhe kontrollin personal të individit. Për t'u realizuar kjo, nevojiten gjithsesi edhe organizatat publike dhe sociale dhe sisteme të fuqishme kontrolli.<sup>23</sup>

## **Ambienti në jetën dhe praktikën e Muhammedit a.s.**

Në studimet e jetës dhe veprimtarisë së Muhammedit a.s. shpeshherë shumë aspekte të jetës së tij ngelen në hije, pa u studiuar mirë. Një prej këtyre aspekteve është edhe kujdesi që ai ka treguar ndaj ambientit. Shumëkush, sipas kësaj, mund të pyesë me habi se çfarë mund të ketë thënë dhe bërë Muhammedi a.s. në shkretëtirë, për çfarë ambienti dhe ekologjie mund të flitet në shek. VII në shkretëtirat e Arabisë. Mirëpo, studimi më i thellë dhe në veçanti nga një këndvështrim ekologjik i jetës dhe i praktikës së tij, do të na habisë me bagazhin e madh dhe të mahnitshëm të fjalëve e veprave të tij në këtë drejtim. Lirisht mund të pretendojmë se ai ka qenë një ambientalist i madh dhe pas vete ka lënë një trashëgimi që mund të quhet "sunnet ekologjik". Me këtë term nënkuptohet dashuria e Muhammedit a.s. ndaj qenieve të gjalla dhe ndaj natyrës si dhe tërësia e fjalëve dhe e veprave të tij në kontekst të ruajtjes së natyrës dhe të gjallesave të tjera në të.<sup>24</sup>

Hadithet e Muhammedit a.s. lidhur me mjedisin si dhe këndvështrimin e tij ambientalist do të mundohemi ta analizojmë në disa nëntituj:

### **1. Motivimi për vepra të mira**

Mendësia që mëtohet të ofrohet në shkallë të parë nga hadithet në raportin njeri-mjedis, është përvetësimi i mënyrës së jetesës së njeriut brenda së mirës dhe së bukurës kundrejt mjedisit. Njeriu që e pranon këtë mënyrë jetese do të jetë konstruktiv kundrejt mjedisit të tij dhe në çdo rast do të mundohet të veprojë drejtë, madje edhe do të ndjejë kënaqësi nga ky veprim. Në rastet kur nuk do të bëjë mirë ose kur nga pahiri do të përzihet në të këqijat, ai shpirtërisht do të ndjehet i mërëzitur dhe i shqetësuar. Një musliman që edhe nga ky prizëm e merr shembull Muhammedin a.s., do të krijojë një jetë dhe një personalitet të mbështetur në të mirën dhe në të bukurën.

Ja disa nga thëniet e Muhammedit a.s. në këtë drejtim:

---

<sup>23</sup> Grup autorësh, *Ilmihal...*, f. 462-463.

<sup>24</sup> Sancaklı, Saffet, po aty, f. 413.

*“Ka thënë All-llahu Fuqplotë: Kush niset të bëjë një vepër të mirë dhe nuk arrin ta bëjë, do t’ia regjistroj si një të mirësi. Kush niset të bëjë një vepër të mirë dhe e bën atë, do t’ia regjistroj atij nga dhjetë deri në shtatëqind fish më shumë...”*<sup>25</sup>

*“Çdo vepër e mirë quhet sadaka (lëmoshë)”*<sup>26</sup>

Një beduin e pyeti Muhammedin a.s.: “Cili është njeriu më i mirë, o i Dërguar i Zotit? Ai u përgjigj: *Ai që rron gjatë dhe bën vepra të mira*”<sup>27</sup>

*“Imani (besimi) përbëhet nga gjashtëdhjetë e ca ose shtatëdhjetë e ca pjesë. Më e larta dhe më e vlefshmja është fjala e dëshmisë se s’ka Zot tjetër pos All-llahut, kurse më e pakta, më e ulëta (pjesë e besimit) është largimi i një pengese nga rruga. Edhe turpi është pjesë e imanit”*<sup>28</sup>

*“Mua mu prezantuan veprat e ummetit tim, të mirat dhe të këqijat. Ndër veprat e mira e pashë largimin e një pengese nga rruga, kurse ndër veprat e këqija e pashë pështymën (gëlbazën) e hedhur në tokë dhe të pambuluar me dhé.”*<sup>29</sup>

*“Një njeri e pa në rrugë një dru (degë, ferrë) që u pengonte njerëzve dhe e largoi mënjane. Për këtë edhe hyri në Xhennet.”*<sup>30</sup>

Tregon Ebu Berzah se ai e ka lutur Muhammedin a.s.: “Mësomë diçka të dobishme, o i Dërguar i Zotit! Ai më tha: *Largoji pengesat nga rruga ku ecin muslimanët (njerëzit)*!”<sup>31</sup>

Të kësaj natyre ka edhe shumë hadithe të tjera. Të gjitha këto kanë një synim: krijimin e qelimit të mirë në qenien njerëzore si dhe gatishmërinë për të krijuar një botë, një mjedis dhe një ambient më të mirë, më të bukur, më të këndshëm dhe më të jetueshëm, që ta përkujton Xhennetin.

## **2. Mjedisi si “vlerë e përbashkët”**

Muhammedi a.s. në një rast ka thënë: *“Muslimanët janë ortakë në tri gjëra: kullosë, ujë dhe zjarr.”*<sup>32</sup> Pra, këto tria janë pronë e përbashkët e të gjithë banorëve të një vendi. Edhe pse ky hadith, në të drejtën klasike islame, është trajtuar nga aspekti i pronës private dhe publike, ne mendojmë se ky hadith ka përmasa akoma më të gjera se kaq, madje globale. Me këtë nuk bëhet fjalë vetëm për ujin e natyrshëm të burimeve, të lumenjve, të liqeneve etj., jo vetëm për kullosat dhe gjelbërimet që kanë mbirë vetvetiu e që nuk janë mbjellë nga dora njerëzore dhe jo vetëm për burimet e zjarrit e të energjisë siç janë drunjtë, xehet, nafta, gazi natyror etj., si prona të përbashkëta të të gjithë banorëve të një vendi, por për më tepër këtu bëhet fjalë për mbjelljen e një vetëdijeje për vlerat e përbashkëta njerëzore. Rrjedhimisht, ajo që është vlerë e përbashkët, nënkupton edhe përgjegjësinë e përbashkët për ruajtjen e saj. Parimet universale që mund të nxirren nga ky hadith janë me sa vijon: 1. këto burime dhe vlera të përbashkëta (uji, kullosa dhe zjarri/energja) duhet t’u sigurohen të gjithëve. Askush dhe asnjë gjallesë nuk guxon të privohet nga këto. Në një hadith Muhammedi a.s. ka thënë: *“Tre vetëve All-*

<sup>25</sup> Muslimi, Iman, 204.

<sup>26</sup> Buhariu, Edeb, 33.

<sup>27</sup> Tirmidhiu, Zuhd, 21.

<sup>28</sup> Muslimi, Iman, 58.

<sup>29</sup> Ibnu Maxheh, Edeb, 7.

<sup>30</sup> Muslimi, Birr, 36; Ibnu Maxhe, Edeb, 7.

<sup>31</sup> Muslim, Birr, 36.

<sup>32</sup> Ebu Davudi, Ixharah, 26.

*llahu nuk do t'u flasë në Ditën e Gjykimit, nuk do t'i pastrojë (falë) ata dhe se ata do të përjetojnë dënim të dhembshëm: i pari është ai që zotëron ujë të tepruar dhe nuk i jep udhëtarit...*"<sup>33</sup>; 2. Këto burime dhe vlera duhet të përdoren drejtë, me masë dhe në mënyrë të baraspeshuar. Në Medine pusi Rume i takonte një çifuti, i cili muslimanëve ujin ua shiste me çmim të lartë. Muhammedi a.s. tha: *"Kush ia blen pusin këtij çifuti, nesër në Xhennet do të ketë një pus të këtillë"*. Doli Osmani r.a., e bleu me paratë e tij dhe e fali vakuf (pronë publike). Lidhur me këtë Muhammedi a.s. tha: *"Sa mirësi të bukur ka bërë Osmani!"*<sup>34</sup> Në një rast tjetër doli një zënkë midis Zubejrit r.a. dhe një banori të Medines lidur me ujitjen e hurmave. Me këtë rast Muhammedi a.s. i tha Zubejrit: *"O Zubejr, ujiti hurmat tua dhe pastaj lëshoje ujin të rrjedhë te fqinji yt!"*<sup>35</sup>; 3. Këto burime dhe vlera duhet të vihen në shërbim të të gjithëve. Siç do të shohim edhe më vonë, Pejgamberi a.s. i ka dhënë rënësi të madhe gjelbërimit, pyllëzimit por në radhë të parë punimit të tokës së djerrë; ai ka ndaluar djegien e natyrës dhe të kafshëve apo insekteve; ai ka ndaluar prerjen pa arsye të drunjve etj. Në një rast Muhammedi a.s. vërejti se dikush pa arsye e kishte prerë një dru lotusi. I zemëruar shumë tha: *"Kush e ka prerë këtë dru, All-llahu e përmbysttë në Xhehennem!"*<sup>36</sup> Të tria këto dhe të ngjashmet me këto duhet të lihen në shërbim të të gjithëve, në mënyrë që të gjithë të mund t'i gëzojnë këto begati të Zotit dhe askush të mos krijojë monopol mbi këto vlera dhe pasuri të përbashkëta. Siç kujdesemi që këto t'i ruajmë e t'i kultivojmë për vetvete, të njëjtën ta mendojmë edhe për të tjerët.<sup>37</sup>

### 3. Rëndësia e pastërtisë

Për çdo kë është e njohur se ç'rëndësi ka pastërtia në jetën personale dhe shoqërore të njeriut, por jo vetëm të tij. Nga këndvështrimi islam, koncepti i pastërtisë përbën tërësinë e pastërtisë shpirtërore dhe materiale, këto janë të pandashme. Pastërtia e shpirtit nënkupton largimin e mendimeve dhe të veseve të këqija e djallëzore. Një shpirt i pastër, një mendje e kulluar dhe një karakter i brumosur me vlera e virtyte, nuk mund të paramendohet t'i bëjë keq njeriut, shoqërisë, mjedisit dhe natyrës. Prandaj edhe Islami i jep përparësi në radhë të parë kësaj pastërtie, e cila përbën edhe lëndën e ahlakut apo të moralit islam. Ngjitas dhe pandashëm me këtë është pastërtia trupore, e teshave, e banesës apo e shtëpisë, e oborrit, e mëhallës, e fshatit si dhe e rrethit ku banon dhe jeton ai. Ky është një zinxhir i pashkëputshëm i cili, thamë që, zanafillën e ka në zemrën dhe shpirtin e njeriut. Një shpirt i kalitur me vlera të larta fisnike nuk e duron dot papastërtinë, bërlllokun, përlyerjen dhe ndotjen. Këto e lëndojnë atë në shpirt, fillimisht. Krahas pastërtisë shpirtërore, Muhammedi a.s. i ka dhënë rëndësi të veçantë edhe asaj materiale, trupore, fizike, mjedisore. Vetë kryerja e ritualeve fetare si namazi, agjërimi, haxhi etj. janë të kushtëzuara me pastërtinë trupore, të teshave dhe të vendit ku këto rituale do të kryhen. Për t'u lutur pesë herë në ditë, parakusht është abdesti, pastrimi me ujë i pjesëve të trupit që në jetën e përditshme janë më tepër në kontakt me gjërat që mund ta ndotin trupin apo petkun e tij. Muhammedi a.s. ka thënë: *"Çelësi i namazit është pastërtia..."*<sup>38</sup> Një ditë Muhammedi a.s. tha: *"Ai që në zemrën e tij ka sa një thërrime kryelartësie e*

<sup>33</sup> Buhariu, Musakah, 5.

<sup>34</sup> Buhariu, Vesaja, 33.

<sup>35</sup> Buhariu, Sulh, 12.

<sup>36</sup> Ebu Davudi, Edeb, 158, 159.

<sup>37</sup> Akyüz, Hüseyin, Ot, Su ve Ateşin Kullanımı İle İlgili Bir Hadisin Güncel ve Evrensel Değeri, *İnsan ve Toplum Bilimleri Araştırmaları Dergisi*, vëll. 4, nr. 1, Stamboll 2015, f. 232-144.

<sup>38</sup> Ebu Davud, Taharah, 31.

*arrogance, nuk do të hyjë në Xhennet.*" Njëri nga të pranishmit i tha: "Njeriu ka dëshirë të veshë tesha të bukura dhe mbathje të bukura (a quhet edhe kjo kryelartësi?). Muhammedi a.s. iu përgjigj: *"All-llahu është i bukur dhe e do bukurinë. Kryelartësia nënkupton përçmimin e së vërtetës (nga vetë mendjemadhësia) dhe përbuzjen e njerëzve."*<sup>39</sup>

Sipas kësaj, muslimani i vërtetë është një njeri i pastër në shpirt, i pastër në trup e në veshje, i pastër në vendin ku jeton dhe vepron; ai është një njeri të cilit nuk i ka hije e kundërta e kësaj. Sigurisht që ai pritet të jetojë në një botë të pastër materialisht me ujin, me ajrin, me tokën dhe me rrethin; të pastër shpirtërisht me shoqërinë e tij, me botën e tij shpirtërore dhe morale.<sup>40</sup>

Muhammedi a.s. aq shumë rëndësi i ka dhënë pastërtisë fizike sa që ka urdhëruar që muslimani më së paku njëherë në javë të bëjë banjë<sup>41</sup>, t'i presë thonjtë, t'i rruajë qimet nën sqetull dhe te vendet e turpit, t'i shkurtojë mustaqet<sup>42</sup>, t'i lajë duart para dhe pas buke<sup>43</sup>, ta ruajë pastërtinë e gojës dhe të dhëmbëve duke e përdorur *misvakun* (lloj brushe nga druri)<sup>44</sup>...

Në shumë hadithe të Muhammedit a.s. flitet për rëndësinë e ruajtjes së pastërtisë së ujit dhe të pushimoreve të njerëzve. Kështu ai ka thënë: *"Ruhuni nga dy sende që shkaktojnë mallkimin! E pyetën: Ç'janë ato, o i Dërguar i Zotit? Ai tha: Të kryesh nevojën (fiziologjike) në vendkalimet e njerëzve ose nën hijet e pemëve (ku pushojnë njerëzit dhe bagëtia)".*<sup>45</sup> Ai po ashtu ka kërkuar që vathët e kafshëve të vendosen larg burimeve apo rrjedhave të ujit<sup>46</sup> dhe ka ndaluar urinimin sidomos në ujin që nuk rrjedh<sup>47</sup>. Për fat të keq, sot sa e sa lumenj, liqene, dete dhe brigje të tyre po ndoten fillimisht nga rrjedhat e kanalizimeve, nga ujërat e zeza të fabrikave, nga nafta që rrjedh a derdhet nga anijet-cisternë, nga testimet e armëve të ndryshme kimike, biologjike e nukleare në dete e oqeanë?!

#### 4. Gjelbërimi dhe pyllëzimi

Duhet theksuar se Muhammedi a.s. që nga fëmijëria e tij ka qenë i lidhur ngushtë me natyrën dhe mjedisin e tij. Ai vetë ka deklaruar se si fëmijë dhe djalosh i ri ka shërbyer si bari në rrethinat e Mekkes: *"All-llahu nuk ka dërguar asnjë peygamber dhe që ai të mos ketë qenë (fillimisht) bari. I thanë: A edhe ti ke qenë bari, o i Dërguar i Zotit? Tha: Po, edhe unë i kam ruajtur bagëtinë e banorëve të Mekkes për disa kirat (shumë të hollash)."*<sup>48</sup> Përveç kësaj, në periudhat e mëvonshme të jetës së tij, edhe ai vetë ka pasur disa kafshë (kuaj, dhen, dhi etj.), por edhe kopshte e vreshta.<sup>49</sup> I rritur në kushte të këtilla, ai sigurisht që ka pasur një kujdes të veçantë ndaj mjedisit dhe ka shërbyer si model për të tjerët në këtë drejtim.

---

<sup>39</sup> Muslimi, Iman, 39.

<sup>40</sup> Canan, İbrahim, *Çevre Ahlakı*, Yeni Asya Yay., Stamboll 1995, f. 17.

<sup>41</sup> Buhariu, Xhumu'ah, 2.

<sup>42</sup> Buhariu, Libas, 63-64.

<sup>43</sup> Ebu Davudi, Et'imeh, 11-12; Tirmidhiu, Et'imeh, 39.

<sup>44</sup> Buhariu, Saum, 27.

<sup>45</sup> Muslimi, Taharah, 20; Ebu Davudi, Taharah, 14.

<sup>46</sup> Ibnu Maxheh, Ruhun, 22.

<sup>47</sup> Muslimi, Taharah, 96.

<sup>48</sup> Buhariu, Ixharah, 2.

<sup>49</sup> Sancaklı, Saffet, *Fakirlik ve Zenginlikle İlgili Hadisler Üzerine Bir Deneme*, Cumhuriyet Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi, vëll. V, nr. 1, Sivas 2001, f. 351 ff.

Ai është angazhuar për pyllëzimin e mjedisit kudo që ka qenë e mundshme. Historiografi el-Beladhuri (v. 892) në librin e tij *Futuhu'l-Buldan* shënon ngjarjen në vijim: Kur Muhammedi a.s. ishte në vendin e quajtur Dhurajb et-Te'vil (me siguri në kthim e sipër nga ekspedita Dhu Kard) një person nga Medina i thotë atij duke iu referuar malit aty pranë: "O i Dërguar i Zotit, këtu në këtë vend ne i pushojmë devetë dhe i kullosim dhentë..." Atëherë Muhammedi a.s. tha: "*Kushdo që këtu pret ndonjë dru, në vend të tij le të mbjellë një tjetër si kompensim për të!*" dhe kështu me kalimin e kohës ky vend u quajt el-Gabeh (pyll).<sup>50</sup> Ajo që sot është praktikë e zakonshme në shtetet moderne, Muhammedi a.s. e nisi që në shek. VII, pra zëvendësimin e çdo druri të prerë me një dru apo fidan tjetër të mbjellë rishtazi.

Muhammedi a.s. 12 milje rreth e përqark Medines, nga qendra e saj, i shpalli si "zona të ndaluara" (*haram*), ku ishte e ndaluar prerja e drunjve, këputja e gjetheve, prishja e kullotave, mbytja e kafshëve apo gjuetia, etj. Ai ka thënë: "*Ibrahimi a.s. e ka shpallur Mekken të shenjtë (të paprekshme), kurse unë e shpall Medinen, që nodhet midis dy shkëmbinjve, të shenjtë (të paprekshme). (Në këtë hapësirë) nuk pritet asnjë dru dhe nuk mund të ndiqet (për gjueti) asnjë kafshë!*".<sup>51</sup> Përcjell Enes bin Maliku r.a. se derisa ishim duke u kthyer nga lufta e Hajberit, kur mbërritëm pranë kodrës Uhud, Muhammedi a.s. tha: "*Kjo kodër na do ne dhe ne e duam atë*". Pastaj bëri me shenjë drejt Medines dhe tha: "*O Allah! Po e shpall të paprekshme (të ndaluar) hapësirën midis këtyre dy shkëmbinjve të Medines, ashtu siç e shpalli të paprekshme Ibrahimi (a.s.) Mekken...*"<sup>52</sup> Të mësuar dhe të inspiruar nga Muhammedi a.s., edhe shokët e tij më vonë do ta respektojnë dhe kultivojnë në vazhdimësi kujdesin ndaj mjedisit. Përcjell Ebu Hurejreja r.a. se pasi Muhammedi a.s. e shpalli të paprekshme, të mbrojtur, zonën përreth Medines: "*Unë edhe sikur të shihja ndonjë dre duke kullotur, nuk e trembja më, sepse dymbëdhjetë milje përreth Medines ai (Muhammedi a.s.) e shpalli hima (zonë të mbrojtur)*".<sup>53</sup> Po kështu edhe Sa'd bin Vekkasi r.a. një ditë e pa një skllav se si po priste drunj apo ua shkundte gjethet. E ndaloi nga kjo dhe si ndëshkim ia mori sendet me vlerë që ai i kishte...<sup>54</sup>

Historiani i mirënjohur Muhammed Hamidullah shënon në detaje rastin kur banorët e qytetit të Taifit e pranojnë Islamin, mirëpo paraprakisht një delegacion i tyre bëjnë një marrëveshje me Muhammedin a.s. në Ramazan të vitit 9 pas hixhretit. Pika katër e kësaj marrëveshjeje, të cilën autori e sjell të plotë, parashikon që lugina e Taifit të shpallet po ashtu e paprekshme, sikurse Meka dhe Medina me rrethinë, ku nuk guxon të dëmtohet në asnjë formë natyra dhe mjedisi i saj. Madje është paraparë edhe dënim për ata që e shkelin këtë pikë të marrëveshjes, pra të dëmtimit të natyrës dhe të kafshëve në të. Në marrëveshjen prej 22 pikash, pika katër parashikonte: "*Lugina e tyre (pra, e banorëve të Taifit – R.N.) në tërësi është e shenjtë dhe aty ndalohet, në emër të Zotit, çdo dëmtim, çdo vjedhje dhe çdo vepër e keqe kundër botës bimore dhe shtazore të saj... As drunjtë gjemborë të luginës së Vexhxit, as kaçubat (vasid) e atyshme nuk mund t'i presë njeri. As shtazët e egra nuk guxon kush t'i vrasë. Kushdo që kapet duke bërë një vepër të tillë të keqe, do të rrihet me kamxhik, i zhveshur. E nëse dikush vazhdon edhe më*

<sup>50</sup> El-Beladhuri, *Futuhu'l-Buldan*, Muesseseh el-Me'arif, Beirut 1987, f. 18; al-Baladhuri, *The Origins of Islamic State (Kitab Futuh al-Buldan)*, nga arab. Philip Khuri Hitti, New York Columbia University, 1916, f. 24.

<sup>51</sup> Muslimi, Haxhixh, 456-459.

<sup>52</sup> Buhariu, Xhihad, 71.

<sup>53</sup> Muslimi, Haxhixh, 472.

<sup>54</sup> Muslimi, po aty, 461.

*tutje, do të kapet dhe do të çohet përpara Pejgamberit Muhammed. Ky është urdhër i Pejgamberit Muhammed, të Dërguarit të All-llahut.*"<sup>55</sup>

Në saje të angazhimit të Muhammedit a.s., siç pamë, Mekka me rrethinë, Medina me rrethinë si dhe qyteti Taif me rrethinë shpallen qysh atëherë si zona të mbrojtura ose si "parqe nacionale", ku theks të veçantë i vihet gjelbërimit dhe pyllëzimit të ambientit.

Ajetet kur'anore që flasin për drunjtë ose pemët janë të shpërndarë në tërë Kur'anin, që nga suret e para deri tek ato të fundit, në mënyrë shumë të baraspeshuar. Përsëritja e shpeshtë dhe në kontekste të ndryshme e fjalës "dru" ose "pemë" në Kur'an, e mban gjallë imazhin e tij në kokën e atij që e lexon Kur'anin me vëmendje të plotë. Kështu që, besimtari i cili e kupton në mënyrë të gjallë dhe shumë tërheqëse rëndësinë shoqërore dhe qytetëruese të drurit, mbjelljen dhe mbrojtjen e drunjve e sheh si formë adhurimi dhe këtë e bën me kënaqësi të thellë shpirtërore.<sup>56</sup> Duke qenë se në çdo aspekt të jetës Muhammedi a.s. ishte një shëmbëlltë, edhe në pyllëzimin e mjedisit ka qenë angazhuar personalisht duke mbjellë afërsisht 500 drunj hurme.<sup>57</sup> Ai nuk ka lejuar që tokat djerrinë të ngelin të tilla përgjithmonë, porse i ka motivuar njerëzit që t'i gjallërojnë ato, t'i gjelbërojnë e t'i mbjellin. Kështu ai ka thënë shumë qartë: "*Kush e ngjall një tokë të vdekur, ajo i takon atij.*"<sup>58</sup> Kjo, në kushtet e asaj kohe kur kishte pjesë të tokës që nuk i takonte askujt dhe ishte e lënë djerrinë.

Thëniet e Muhammedit a.s., sa i takon kujdesit për mbjelljen e tokës dhe pyllëzimin, janë të shumta, çka edhe një herë tregon angazhimin maksimal të tij prej ambientalisti të vërtetë.

Ai e ka ngritur në shkallë ibadeti apo adhurimi mbjelljen e tokës si dhe pyllëzimin: "*Kushdo që mbjell një pemë ose mbjell drithë e pastaj prej tyre hanë shpezët, njeriu ose kafshët, këtij do t'i quhet sadaka (shpërblim lëmoshe).*"<sup>59</sup>

Madje edhe nëse dikë e kap dita e fundit në këtë botë, pra Kijameti, dhe në dorë ka një fidan peme që ka nisur ta mbjellë, Pejgamberi a.s. preferon që këtë ta bëjë, edhe pse pas kësaj dite nuk ka më jetë, nuk ka më kohë që ajo pemë të rritet e të japë fruta. Ai thotë: "*Në qoftë se dikë prej jush e kap kijameti, kurse në dorë ka një fidan, le ta mbjellë!*"<sup>60</sup> Kjo tregon edhe një herë dashurinë që duhet ta kultivojë njeriu ndaj mjedisit ku jeton. Pra, edhe në momentin më kritik, besimtari nuk përton të mbjellë tokën apo pemën, pavarësisht nëse do të ushqehet dhe do të përfitojë ai vetë nga ajo ose jo. Ky është një mesazh i fuqishëm për vetëdijen tonë moderne, se çfarë bote dhe çfarë mjedisi po u lëmë trashëgim pasardhësve tanë.

Në traditën islame, duke u mbështetur në fjalët e Muhammedit a.s., ka diçka që quhet *sadakai xharijeh*, që nënkupton një *sadaka* apo lëmoshë që e ka dhënë muslimani sa ka qenë gjallë për të mirën e shoqërisë. Sipas këtyre mësimëve, sevapet apo shpërblimet për këto vepra të mira do të vazhdojnë t'i shënohen në regjistrin e veprave të mira këtij personi edhe pasi të ketë vdekur ky, pra i rrjedhin atij vazhdimisht derisa të shfrytëzohen nga të ngelët gjallë ato që ka lënë mbas vetes ky. Këto zakonisht janë: ura, shtretër lumenjsh, rrugë, mbjellje drunjsh apo gjelbërim i tokës dhe gjithçka tjetër që vihet në shërbim të njerëzimit, të kafshëve, të shpezëve-

<sup>55</sup> Hamidullah, Muhammed, *Muhammedi a.s. – Jeta dhe Vepra*, vëll. I, nga frëngjishtja Ruzhdi Ushaku, Logos-A, Shkup 2011, f. 409-411.

<sup>56</sup> Canan, Ibrahim, po aty, f. 52.

<sup>57</sup> Ahmed bin Hanbel, Musned, V, 440.

<sup>58</sup> Tirmidhiu, Ahkam, 38; Ebu Davudi, Haraxh, 37.

<sup>59</sup> Buhariu, Muzara'a, 1; Muslimi, Musakah, 12.

<sup>60</sup> Buhariu, Edebu'l-Mufred, 480.

ve etj. Kjo, i jep ambientalizmit në Islam një dimension tjetër shpirtëror, e lidh edhe me mirëqenien në botën tjetër.

## 5. Dhembshuria ndaj kafshëve

Më lart përmendëm se Muhammedi a.s. qysh si fëmijë dhe i ri ishte në kontakt të drejtpërdrejtë me ambientin dhe me kafshët, pasi shërbeu si bari, duke i ruajtur me pagë dhentë dhe devetë e mekasve, për të kontribuar sadopak në mirëqenien materiale të axhës së vet, Ebu Talibit. Për këtë shërbim dhe bashkëjetesë me ambientin dhe me kafshët, ai do të flasë me admirim edhe më vonë pasi t'i vjen pejgamberia. Mirëpo jo që vetëm do të flasë, por edhe do të merret vetë me kultivimin e kafshëve dhe do t'u shërbejë atyre. Dikush e pyeti Aishen r.a., të shoqen e tij, se çka bënte Pejgamberi a.s. kur ishte në shtëpi? Ajo u përgjigj: *Po, i Dërguari i Zotit i riparonte vetë këpucët e veta, i arronte apo qepte teshat e veta, i milte dhentë, i shërbente vetes dhe i bënte punët e tjera të shtëpisë si çdo burrë.*<sup>61</sup>

Për këtë arsye ai edhe do ta proklamojë vlerësimin dhe respektimin më të lartë ndaj kafshëve dhe gjallesave të tjera në natyrë, të cilat bashkë me njeriun dhe bimët e përbëjnë biodiversitetin më të bukur e më të larmishëm që e ka krijuar Zoti. Kështu ai thotë: *“Kundrejt atyre që janë të mëshirshëm, do të jetë i mëshirshëm edhe er-Rahmani (Zoti i Plotmëshirshëm). Jini të mëshirshëm në tokë, që të jetë i mëshirshëm ndaj jush Ai që është në qiell (pra Zoti)...”*<sup>62</sup> Po ashtu ka thënë: *“Kush nuk mëshiron, nuk do të mëshirohet.”*<sup>63</sup>

Këto dy hadithe e përbëjnë bazën dhe thelbin e mënyrës së sjelljes njerëzore në sipërfaqen e tokës, jo vetëm ndaj njerëzve, por edhe ndaj gjallesave të tjera dhe ndaj mbarë mjedisit. Nuk e di në mund të paramendohet një njeri i mëshirshëm ndaj njerëzve, por i egër ndaj gjallesave e ambientit, dhe e kundërta. Shpirti fisnik i kalitur me virtytet më të larta është i tillë ndaj çdo gjëje që e rrethon atë. Nëse nuk është kështu, atëherë nuk mund të quhet fisnik dhe i mëshirshëm, i dhembshur. Duke u mbështetur në rekomandimet dhe direktivat e Muhammedit a.s., më vonë në të drejtën islame do të përcaktohet edhe juridikisht raporti i muslimanit ndaj kafshëve, të drejtat e kafshëve e të ngjashme.<sup>64</sup>

Nisur nga kjo, Muhammedi a.s. e ndaloi përdorimin e forcës fizike kundrejt kafshëve. Përcjell Ebu Hurejreja r.a. se një ditë Muhammedi a.s. pasi e fali namazin e sabahut, u kthye nga njerëzit dhe tha: *“Derisa një njeri ishte duke e drejtuar një lopë, papritmas i hipi asaj mbi shpinë dhe nisi ta rrahë atë. Atëherë lopa tha: Po ne nuk jemi krijuar për këtë (pra, për t'u rrahur), por për ta lëvruar tokën!”*<sup>65</sup>

Ai e ndaloi praktikën e asaj kohe, sipas së cilës kafshët e gjalla i merrnin si shënjestër për shigjetat e tyre. Përcjell Hisham bin Zejdi: *“Bashkë me Enesin shkuam te shtëpia e Hakem bin Ejjubit. Aty i pamë disa djem që e gjuanin një pulë të lidhur. Enesi u tha atyre: Muhammedi a.s. e ka ndaluar gjuajtjen e kafshëve të lidhura, të mbyllura.”*<sup>66</sup> Një rast i ngjashëm me këtë është ky: përcjell Ibni Omeri r.a. se ai një ditë i pa disa të rinj që e kishin lidhur një shpend

<sup>61</sup> Ahmed, Musned.

<sup>62</sup> Tirmidhiu, Birr, 16.

<sup>63</sup> Buhariu, Edeb, 18; Muslimi, Fedail, 65.

<sup>64</sup> Grup autorësh, *İlmihal...*, f. 174-178.

<sup>65</sup> Buhariu, Enbija', 54.

<sup>66</sup> Buhariu, Dhebaih, 25.

dhe gjuanin në të. Ky iu afrua atyre, e liroi shpendin dhe i pyeti se kush e kishte bërë këtë dhe u tha se *Muhammedi a.s. e ka mallkuar atë njeri i cili qeniet e gjalla i përdor për shënjestër.*<sup>67</sup>

Muhammedi a.s. e ka ndaluar edhe zënien e kafshëve për të bërë qejf njerëzit përreth tyre. Përcjell Ibni Abbasi r.a. se Pejgamberi a.s. e ka ndaluar nxitjen e kafshëve për t'u zënë.<sup>68</sup>

Ai e ka ndaluar gjymtimin e kafshëve, duke u prerë organe apo pjesë të trupit, për së gjalli të tyre. Përcjell Ibni Omeri r.a.: *"Muhammedi a.s. e ka mallkuar atë njeri që i gjymton kafshët."*<sup>69</sup>

Ai nuk e ka miratuar gjuetinë që bëhet për qejf, për të ngopur prirjet sadiste të njeriut. Atë e ka konsideruar të dëmshme.<sup>70</sup> Ai e ka ndaluar edhe përdorimin e hobesë\* në gjueti, për shkak të vuajtjes që shkakton ajo me rastin e gjuajtjes. Përcjell Said bin Xhubejri r.a. se një person gjuajti me hobe. Ky e ndaloi nga përdorimi i saj dhe i tha se Pejgamberi a.s. e ka ndaluar këtë, sepse ajo *as nuk e mbyt gjahun, as nuk e lëndon armikun, por ama ta thyen dhëmbin dhe ta nxjerr syrin.*<sup>71</sup>

Muhammedi a.s. na tërheq vërejtjen për hakun e kafshëve dhe të shpezëve si dhe për konsekuencat e keqtrajtimit të tyre, sepse për këto do të përgjigjemi nesër përpara Zotit në botën tjetër. Përcjell Sheridi r.a. nga Pejgamberi a.s. të ketë thënë: *"Kush e mbyt një zog së koti, pa arsye, ai do t'i kërkojë ndihmë Zotit nesër në Ditën e Gjykimit duke thënë: O Zot, ky njeri më mbyti pa arsye, nuk më mbyti për të pasur ndonjë dobi prej meje!"*<sup>72</sup> Po kështu përcjell Abdullah bin Amri r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë: *"Kush e mbyt një zog, ose diçka më të madhe se zogu, me pa të drejtë, nesër në Ditën e Gjykimit All-llahu do ta marrë në pyetje atë njeri."* Dikush i tha: "E çka është (mbytje) me të drejtë, o i Dërguar i Zotit?" Ai u përgjigj: *"Mbytje me të drejtë është nëse ti e vret, e ther dhe e ha, e jo t'ia këpusësh kokën dhe ta hedhësh mënjane."*<sup>73</sup>

Duke qenë se therja e kafshëve, të cilave fetarisht u lejohet ngrënia e mishit, është një nevojë njerëzore, edhe në këtë drejtim Pejgamberi a.s. kërkon kujdesin maksimal. Përcjell Sheddad bin Eusi r.a. duke thënë se dy gjëra i ka mësuar përmendsh nga Muhammedi a.s.: *"Vërtet All-llahu na ka obliguar që në gjithçka të sillemi me mirësi dhe butësi. Prandaj, kur të mbytni një kafshë, bëjeni me mirësi, kur të therni një kafshë, bëjeni me mirësi. Mpriheni thikën mirë, në mënyrë që kafsha të rehatohet (të mos e ndiejë dhimbjen)."*<sup>74</sup>

Keqtrajtimitin e kafshëve ai e ka gjykuar prerë dhe haptazi. Përcjell Abdullah bin Omeri r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë: *"Një grua do të dënohet në xhehennem për shkak të një maceje, të cilën ajo e kishte burgosur dhe nuk e kishte ushqyer, nuk i kishte dhënë ujë, por as edhe që e kishte lënë të lirë vetë të ushqej në natyrë, derisa më në fund macja kishte vdekur."*<sup>75</sup>

---

<sup>67</sup> Muslimi, Sajd, 59.

<sup>68</sup> Tirmidhiu, Xhihad, 30.

<sup>69</sup> Buhariu, Dhebaih, 25.

<sup>70</sup> Tirmidhiu, Fiten, 69.

\* Hobë është një copë lëkure a diçka e thurur, me dy rripa të hollë ose me dy gjalma të lidhur në dy anët e saj, që përdoret për të gjuajtur me gurë të vegjël, duke e rrotulluar me forcë e duke lëshuar njërin rrip a njërin gjalmë. ASHSH, *Fjalor i Shqipësisë Sotme*, f. 484.

<sup>71</sup> Ibni Maxheh, Sajd, 11.

<sup>72</sup> Nesaiu, Dahaja, 42.

<sup>73</sup> Po aty.

<sup>74</sup> Muslimi, Sajd, 57.

<sup>75</sup> Buhariu, Enbija', 54.



Muhammedi a.s. e ka ndalur damkosjen e kafshëve në fytyrë a në ballë, duke qenë se kjo shkakton dhimbje të madhe në lëkurën e kafshës, pasi bëhet me hekur të skuqur. Përcjell Xhabir bin Abdillahi r.a. një ditë pranë Pejgamberit a.s. kaloi një gomar i damkosur në fytyrë. Pejgamberi a.s. me këtë rast tha: *“All-llahu e mallkoftë atë njeri që e ka damkosur atë!”*<sup>76</sup> Në një version tjetër thuhet: *“A nuk jeni të njoftuar se unë e kam mallkuar atë njeri i cili i damkos dhe i rreh kafshët në fytyrë?!?”*<sup>77</sup>

Ai e ka ndaluar madje edhe mallkimin e kafshëve. Përcjell Imran bin Husajni r.a. se derisa Pejgamberi a.s. ishte në udhëtim e sipër, një grua medinase ndodhej mbi deve. Ajo u tremb nga diçka dhe kjo e mallkoi devenë. Këtë e dëgjoi Pejgamberi a.s. dhe tha: *“Shkarkoni çfarë ka mbi të dhe lëreni devenë të lirë, ajo është e mallkuar”*. Rrëfen Imrani më tutje: akoma më duket sikur e shoh atë devenë në mes të njerëzve dhe askush nuk e angazhon për asgjë.<sup>78</sup>

Pejgamberi a.s. e ka ndaluar dëmtimin e foleve të zogjve dhe rrëmbimin e të vegjëlve të tyre. Rrëfen Abdullah ibni Mes’udi r.a.: Ishim me Pejgamberin a.s. në një udhëtim. Ai u largua pakës për të kryer nevojën. Ne e pamë një zog me dy të vegjlit e tij, të cilët ia morëm. Nëna e tyre filloi të shpërhapte flatrat e saj përreth të vegjëlve të saj. Kur erdhi Pejgamberi a.s. na tha: *“Kush e shqetësoi këtë nënë për të vegjlit e saj? Kthejini prapë aty ku ishin!”*<sup>79</sup>

Sjelljen e mirë ndaj kafshëve Pejgamberi a.s. e ngre në shkallë të *sadakasë* e të *ibadetit* (adhurimit). Ai sjell një shembull shumë tipik. Përcjell Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Një njeri ishte duke udhëtuar dhe e kapi etja e madhe. Aty pranë e gjeti një pus. Zbriti poshtë, piu ujë dhe u ngjiti sërish lart. Kur, aty pranë, e pa një qen që gulçonte dhe e lëpinte tokën nga etja. Tha vetë më vete: këtë qen e paska kapur ajo që më pati kapur edhe mua. Zbriti sërish në pus, e mbushi këpucën e tij me ujë dhe i dha qenit të pinte. All-llahu e falënderoi këtë njeri dhe ia fali mëkatet.”* I thanë të pranishmit: “O i Dërguar i Zotit, a edhe për kafshët do të shpërblehem?” Ai tha: *“Po, do të keni shpërblim për çdo shërbim që ia bëni çdo gjallesë.”*<sup>80</sup>

Në një kohë kur të drejtat e njeriut ishin shkelur me këmbë dhe tani në Islam kur edhe kafshët po fitonin të drejtat e tyre, ishte tejet normale që shokët e Pejgamberit a.s. të befasoheshin për këtë trajtim kaq njerëzor ndaj kafshëve. Ai do të theksojë edhe këtë: *“Kushdo që e braktis një kafshë në një vend ku ajo mund të vdesë, dhe vjen një tjetër dhe e shpëton atë nga vdekja, ajo kafshë i takon atij që e shpëtoi”*.<sup>81</sup> Sot është një praktikë e zakonshme që shteti t’ia marrë kafshët një fermeri, nëse konstatohet se ai i keqtrajton dhe i lë ato të vuajnë. Në Zvicër kemi mjaft raste të këtilla.

## 6. Ruajtja nga harxhimet e kota

Historikisht është e njohur se Muhammedi a.s. vetë ka kaluar një jetë modeste, larg shkapërdhjes dhe harxhimeve të kota, edhe atëherë kur ka pasur mundësinë të jetojë në luks. Këtë

---

<sup>76</sup> Muslimi, Libas, 107.

<sup>77</sup> Ebu Davudi, Xhihad, 905.

<sup>78</sup> Muslimi, Birr, 80.

<sup>79</sup> Ebu Davudi, Xhihad, 122.

<sup>80</sup> Buhariu, Medhalim, 23.

<sup>81</sup> Ebu Davudi, Ixhara, 41.

stil jete ai ua ka preferuar edhe shokëve të tij. Përcillet se Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Ushqehuni por edhe jepni lëmoshë! Vishuni por mos e teproni dhe mos u shitni mendjemëdhenj!”*<sup>82</sup>

Ai gjithmonë është shprehur kundër harxhimeve të kota, bile edhe kur ka qenë në pyetje kryerja e detyrave fetare. Kështu në një hadith ai thotë: *“Vërtet gjatë marrjes së abdestit pranë jush ndodhet një shejtan që quhet Velhan. Kini kujdes të mos ju mashtrojë me ujin!”*<sup>83</sup> Kjo nënkupton dalldisjen e njeriut gjatë marrjes së abdestit dhe me këtë rast nuk e vëren se uji po rrjedh kot. Një ditë Muhamemdi a.s. e pa Sa’d ibni Vekkasin duke marrë abdest, me siguri duke harxhuar ujë më tepër se që kishte nevojë, dhe i tha: *Ç’është ky harxhim i tepërt?* Ai i tha: *A edhe gjatë marrjes së abdestit duhet të kursejmë?* Atëherë ai i tha: *Po, bile edhe nëse gjendesh pranë një lumi që rrjedh”*.<sup>84</sup> Ky hadith do të ishte përgjigje e mirë për ata që mund të pretendonin se nuk kemi nevojë të kursejmë, kur kemi me bollëk. Në fakt, me këtë mësohet një parim jete: të jesh i matur, i kontrolluar dhe të mos harxhosh vend e pavend, sepse kjo ka një çmim të lartë, rrjedhojat e së cilës i përjetojmë më vonë.

Ndjeshmëria e Muhammedit a.s. ndaj harxhimeve të tepërta, madje edhe në punët e fesë, siç ishte rasti me ujin e abdestit, mund të ofrojë një mundësi të çmuar në zgjidhjen e problemeve të mëdha që kanë të bëjnë me mjedisin. S’ka dyshim se harxhimet e tepruara e tëhuajësojnë dhe e largojnë njeriun nga përgjegjësia kozmike që ai e ka, e verbërojnë atë nga detyrat e mëdha që e presin. Për rrjedhojë, sot si faktori kryesor i ndotjes së ambientit shihen pikërisht harxhimet e tepruara që i tejkalojnë nevojat njerëzore, që janë destinuar për plotësimin e tekave, të qejfeve dhe ndjenjave të tjera djallëzore në njeriun. Ai që harxhon më shumë, në të njëjtën kohë e rrit dëshirën për prodhim më të madh të prodhuesve por edhe e shton bërllokun me çka e ndot ambientin. Ky veprim zinxhir është i pashmangshëm, sot ai duket jo vetëm i pandalshëm, por edhe i pakontrollueshëm.<sup>85</sup>

## **Nevoja për rritjen e vetëdijes ambientaliste**

Nga sa pamë më lart, faktori njeri është kryesori në ndotjen e ambientit dhe në keqpërdorimin dhe keqmenaxhimin e tij. Po ashtu mundëm të kuptojmë, së paku nga këndvështrimi islam, se kjo ndotje dhe çrregullim vjen si rrjedhojë e një ndotjeje shpirtërore dhe psikike, në fakt një degradim i brendshëm moral në qenien njerëzore. Njeriu fisnik, siç e thamë më lart, nuk është i egër ndaj mjedisit ku jeton dhe nuk ndot, nuk përlyen. Ndërgjegjja e tij e kulluar nuk e lejon të keqen dhe të shëmtuarën në asnjë fushë, ndaj aq më pak në mjedisin ku jeton. Arsyeya e ndotjes dhe e prishjes ekologjike është, po e ritheksojmë, mungesa e një shikimi të thellë shpirtëror ndaj natyrës; mungesa e një shikimi të tërësishëm, e një panorame gjithëpërfshirëse, e një vetëdijeje metafizike... dominimi i një mendimi apo qëndrimi që natyrën e shikon vetëm si një burim shfrytëzimi material... Qëllimi nuk duhet të jetë dominimi i natyrës apo shndërrimi i saj në produkte industriale, por jetesa në përputhje me natyrën... Natyrën nuk duhet shikuar si një burim të pashtershëm, që nuk ia shohim fundin, por si një kapital tonin personal, të kufizuar, të cilin po e harxhojmë për çdo ditë e më shumë... Për këtë nevojitet shtrirja e mendimeve pozitive dhe të përgjegjshme ndaj natyrës, si përmes arsimit formal nëpër shkolla, ashtu edhe përmes atij joformal, duke e mbjellë ndjenjën e përgjegjësisë kozmike

<sup>82</sup> Nesaiu, Zekah.

<sup>83</sup> Tirmidhiu, Taharah, 43.

<sup>84</sup> Ibni Maxheh, Taharah, 48.

<sup>85</sup> Sancaklı, Saffet, Hz. Peygamber'in Çevrecilik Anlayışı, f. 419-420; Akyüz, Hüseyin, Çevre Dostu..., f. 113-114.

ndaj amanetit të Zotit në shpirtrat e njomë të fëmijëve.<sup>86</sup> Këtu po e theksoj rëndësinë, në fakt përgjegjësinë, edhe të teologëve dhe imamlerëve, të cilët në predikimet e tyre dhe në kontaktin e vazhdueshëm që e kanë me vetë popullin, mund të ndikojnë shumë në ngritjen e një vetëdijeje për një ambient më të pastër, më të bukur dhe më të banueshëm, konform mesimeve kur'anore dhe të Muhammedit a.s. Kjo ngritje, medoemos duhet të jetë ngritje e një vetëdijeje kolektive, madje globale. Ashtu siç u formua një vetëdije kolektive gjithëbotërore, për shembull, për çrrënjosjen e skllavërisë klasike, për ndjeshmërinë ndaj sëmundjeve ngjitëse etj., e të njëjtit format, e të njëjtave përmasa, duhet të jetë edhe niveli i vetëdijes dhe ndjenja e përgjegjësisë në raport me mjedisin dhe me planetin tokë. Përndryshe, rezultati i angazhimeve personale dhe grupore do të ngelë me efekt të vogël dhe tejet të kufizuar.

## **Përmbyllje**

Përmasat e ndotjes së ambientit, të ndryshimeve klimatike, të prishjes së ekuilibrit ekologjik janë më se evidente. Këtë e vërejmë dhe e përjetojmë gjithandej. Përpyekjet e njerëzve të arsyeshëm për ta penguar këtë dukuri, ngelen të kufizuara, sepse nuk gjejnë mbështetjen morale dhe materiale për ta çuar këtë brengë më tutje. Ndërkaq gatishmëria e atyre, që më së shumti e ndotin ambientin, për ta reduktuar veprimtarinë e tyre ndotëse dhe çekuilibruese nuk duket në horizont. Marrëveshjet e lidhura ndërkombëtarisht nuk respektohen, madje anashkalojnë sikur të mos ekzistonin fare. Ky hov i vetëshkatërrimit tonë në planetin tokë duket i pandalshëm dhe i pakontrollueshëm. Megjithëkëtë, ne na mban shpresa se megjithëkëtë brezat e rinj do të veprojnë më arsyeshëm dhe në mënyrë më humane, në favor të ruajtjes së mbarë biodiversitetit të dhuruar nga Zoti. Mësimet kur'anore dhe të Pejgamberit Muhammed a.s. për ne muslimanët janë një arsye më tepër për t'u angazhuar më aktivisht në përpyekjet mbarëbotërore për ndalimin apo kontrollimin e këtij vetëshkatërrimi. Këto mësimet duhet të përvetësohen mirë, të bëhen pjesë e mendësisë, e të menduarit, e botëkuptimit tonë dhe rrjedhimisht pjesë e jetës sonë. Ky thesar i madh kur'anor dhe sunnetik jo vetëm që na motivon, ai njëkohësisht edhe na obligon, që t'i thërrasim arsyet së shëndoshë dhe ndërmarrjes së hapave që kërkohen në drejtim të ruajtjes së begatave të Zotit që Ai ne na ka lënë amanet, në besim. Moskujdesi ynë ndaj këtij amaneti, nënkupton tradhtinë e tij. Termin tradhtar ndërkaq nuk duam t'i ngjitem askujt, por secili prej nesh le ta sodisë vetveten, në mos jam unë njëri prej tradhtarëve të tij.

Kreuzlingen (CH), 17.10.2019

---

<sup>86</sup> Sancaklı, Saffet, po aty, f. 420-421.

## Literatura:

- Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Fjalor i Shqipërisë Sotme*, Botimet Toena, Tiranë 2002
- Akyüz, Hüseyin, “Çevre dostu bir Peygamber: Hz. Muhammed”, *Journal of Turkish Studies*, vëll. 9/2, dimër 2014 Ankara
- Akyüz, Hüseyin, Ot, Su ve Ateşin Kullanımı İle İlgili Bir Hadisin Güncel ve Evrensel Değeri, *İnsan ve Toplum Bilimleri Araştırmaları Dergisi*, vëll. 4, nr. 1, Stamboll 2015
- al-Baladhuri, *The Origins of Islamic State (Kitab Futuh al-Buldan)*, nga arab. Philip Khuri Hitti, New York Columbia University, 1916
- Bahjat, Ahmad, *Animals in the Glorious Qur'an – Relating Their Own Stories*, në [www.archive.org](http://www.archive.org)
- Bahjat, Ahmad, *Kisas el-hajevan fi'l-Kur'an*, Dar al-Shuruk, bot. 4, Kajro 2000
- Canan, İbrahim, *Çevre Ahlakı*, Yeni Asya Yay., Stamboll 1995
- Darakhsha, Kauser & Ashwini, Kumar Dixit, Plants in the Holy Quran: A Look, *World Journal of Pharmacy and Pharmaceutical Sciences*, vëll. 4, nr. 8, Bilaspur 2015
- Doğan, Mehmet, *Büyük Türkçe Sözlük*, Vadi Yayınları, Ankara 2001
- el-Beladhuri, *Futuhu'l-Buldan*, Muesseseh el-Me'arif, Bejrut 1987
- el-Faruki, Ismail Raxhi, *Tevhidi – Implikimet e tij për mendimin dhe jetën*, Logos-A, Shkup 2006
- el-Xheuzi, Ibën Kajjim, *Përshkrimi i Xhennetit*, Shkup 2005
- Grup autorësh, *Fjalor i Fjalëve të Huaja*, Rilindja, Prishtinë 1988
- Grup autorësh, *İlmihal – İslam ve Toplum*, İSAM, vëll. II, Ankara 2001
- Güven, Mustafa, “Kur'ân-ı Kerim'de Çevre Bilincine Dair Bazı Ahlâkî Esaslar”, revista *Birey ve Toplum*, vëll. 4, nr. 2, Stamboll 2014
- Hamidullah, Muhammed, *Muhammedi a.s. – Jeta dhe Vepra*, vëll. I, nga frëngjishtja Ruzhdi Ushaku, Logos-A, Shkup 2011
- Instituti i Politikave Mjedisore: [www.iep-al.org](http://www.iep-al.org)
- *Islamic Declaration on Global Climate Change*, Stamboll 2015, në [www.ifees.org.uk](http://www.ifees.org.uk)
- Karić, Enes, Ekološke Poruke Kur'ana – Uvodna razmatranja, *Novi Muallim*, nr. 35, 29, shtator 2008
- Memishi, Isa, *Fjalor arabisht – shqip*, Logos A, Shkup 2014
- Özdemir, İbrahim, *Çevre ve Din*, Çevre Bakanlığı Yayınları, Ankara 1997
- Sancaklı, Saffet, Fakirlik ve Zenginlikle İlgili Hadisler Üzerine Bir Deneme, *Cumhuriyet Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi*, vëll. V, nr. 1, Sivas 2001
- Sancaklı, Saffet, Hz. Pezgamber'in Çevrecilik Anlayışı, *İslami Araştırmalar Dergisi*, cilt 14, sayı 3-4, Ankara 2001
- Von Denfer, Ahmad, *Islam und Umwelt*, Islamisches Zentrum München, 1999